



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:257002

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812839

C.nr.1058/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses SH.K nga fshati V.ZH, Komuna GJ, me vendbanim në P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga O.H dhe S.B, të dy avokatë me seli në P, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga M.D dhe A.P, të dy avokatë me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 28,250.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.07.06.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datën 12.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditëses SH.K nga fshati V.ZH, Komuna GJ, me vendbanim në P, ashtu që: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit të pësuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar me datën 26.02.2018 në P, Rr. "A.R", t'ia paguajë shumat si në vijim:

- Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje fizike, shumën prej.....2,500 €

- Për friken e përjetuar, shumën prej.....2,300 €

- Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....300,00 €

- Për ndihmën e personit të tretë, shumën prej.....250,00 €

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditëses SH.K, shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me normën e kamatës ligjore në lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.12.06.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të

llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.03.04.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimtë përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses SH.K, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dëmit jo - material: për dhimbjet fizike në shumën prej 5,500 € dhe për frikën e përjetuar në shumën prej 4,000 €; në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar në shumën prej 700.00 € dhe për ndihmën e personit të tretë në shumën prej 800.00 €. Po ashtu, refuzohet në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditëses, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor t'ia paguajë shumën prej 9,000 €, në emër të rehabilitimit fiziatriko - psikik shumën prej 1,700 €, si dhe në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 1,200 €.

IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditëses SH.K, në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë kontestimore, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 177.66 € (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësja SH.K nga fshati V.ZH, tani me vendbanim në P, përmes përfaqësuesve të autorizuar, O.H dhe S.B, të dy avokatë në P, pranë kësaj gjykate, me dt.03.04.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ndër tjera pretendohet se me datën 26.02.2018, në orën 10:50 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në rrugën "A.R" në Prishtinë, duke shtuar tutje se referuar raportit policor, deri te ky aksident ka ardhur deri sa shoferi i veturës "A" i markës "V" tipi ..., e vitit ..., me targa të regjistrimit ..., ngjyrë ..., i cili në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar te e paditura, ishte duke lëvizur në rrugën "A.R", drejtimi i lëvizjes prej rreth rrotullimit te Komuna e Prishtinës në drejtim të udhëkryqit të ..., dhe me të arritur te vendkalimi i shënuar për këmbësor, vetura "A" nuk e respekton shenjën e trafikut "vendkalim për këmbësorë", me ç'rast me pjesën e përparme të anës së majtë e godet këmbësoren - këtu paditësen, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. Më tutje pretendohet se si pasojë e aksidentit të pësuar, paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore të përcjella me dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe shëmtim trupor. Po ashtu pretendohet se ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar, ndihma e personit të tretë dhe shërimi klinik. Me qëllim të realizimit të të drejtës në kompensim, paditësja ka parashtruar padi, duke i propozuar Gjykatës që të caktojë shqyrtim gjyqësor dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike nga provat e administruara në kuptim të dispozitave nga nenet 136, 140, 159 dhe 183 të LMD-së, të nxjerrë aktgjykim me të cilin aprovet në tërësi kërkesëpadi.

Në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, paditësja përmes përfaqësuesve të autorizuar ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa me qëllim të vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë, respektivisht përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, ka propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e komunikacionit. Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadisë, ka propozuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Me rastin e pranimit të ekspertizave përkatëse, përfaqësuesit e autorizuar të paditëses kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje në të njejtat dhe nuk kërkojnë sqarime shtesë. Përmes precizimit të kërkesëpadisë, të dorëzuar edhe në formën e parashtresës në seancën e dt.07.06.2024, ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, duke e detyruar të paditurën që në emër të shpërblimit të dëmit për lëndimet e pësura në aksidentin e komunikacionit, t'ia paguajë paditëses shumat si në vijim: për dhimbjet fizike shumë prej 8,000 €; për frikën e përjetuar shumë prej 6,300 €; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 9,000 €; për rehabilitimin fiziatriko-psikik shumë prej 1,700 €; për ushqim të përforcuar shumë prej 1,000 €; për përkujdesje nga personi i tretë shumë prej 1,050 €, si dhe për shpenzimet e shërimit, shumë prej 1,200 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 €; për precizim të padisë shumë prej 208.00 €; për 4 seanca gjyqësore shumë prej 540.00 €; për taksë gjyqësore shumë prej 21.00 €; për shpenzimet e ekspertizave shumë prej 400.00 €, apo shumë e përgjithshme prej 940.00 €.

Pala e paditur, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësuesve të autorizuar, fillimisht ka deklaruar se e konteston pjesërisht bazën juridike të kërkesëpadisë dhe kontributin eventuale të vetë paditëses në shkaktimin e aksidentit. Propozimet për nxjerrjen e provave përmes ekspertizës nga lëmia e komunikacionit, respektivisht mjekësore nuk i ka kundërshtuar. Me rastin e pranimit të ekspertizave përkatëse, respektivisht sqarimeve të dhëna nga ekspertët përkatës në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se nuk ka vërejtje nga këto ekspertiza. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara rezulton që nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia, mbi bazën e argumentit se shumat e kërkuara nga pala paditëse janë tejet të larta dhe nuk janë në përputhje me mendimin dhe konstatimin e dhënë nga ekspertët përkatës, duke i propozuar Gjykatës që me rastin e vendosjes të ketë parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertëve, praktikën gjyqësore dhe kriteret e përcaktuara nga BQK. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.07.06.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale vijuese: Raporti i aksidentit Nr.2018-AR-0471, i përpiluar me datë 26.02.2018; Foto - dokumentacioni nga vendi i ngjarjes; Raporti i lëshuar nga QKUK, me numër 744, i dt.26.02.2018; Raportet e QKUK - Instituti i Biokimisë Klinike, të dt.27.02.2018; Raportet specialiste të dt.26.02.2018; 09.03.2018; Formulari për caktim të ekzaminimit i dt.29.03.2018; Udhëzimi për konsultim i dt.19.03.2018; Fletëlëshimi i dt.20.03.2018; Ekspertiza nga lëmia e komunikacionit, e përpiluar nga eksperti A.B, e

dt.26.03.2024; Ekspertiza mjekësore, e përpiluar nga Dr. XH.S - Ortoped dhe Dr. V.B - Psikiatre e dt.08.05.2024.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse nuk kanë parashtruar vërejtje në raport me provat e administruara.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se me dt.26.02.2018, rreth orës 10:50, në rrugën "A.R" në P, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, në të cilin ishte e përfshirë këtu paditësja. Hollësitë e këtij aksidenti fillimisht janë evidentuar në raportin e aksidentit Nr.2018-AR-0471, të përpiluar me datë 26.02.2018. Sipas këtij raporti është konstatuar se deri te aksidenti i trafikut dyshohet të ketë ardhur deri sa shoferi i veturës "A", i cili ishte duke vozitur në rrugën "A.R", drejtimi i lëvizjes ishte prej rreth rrotullimit të Komuna e Prishtinës në drejtim të udhëkryqit të ... dhe me të ardhur të vendkalimi i shënuar për këmbësorë nuk e respekton shenjën e trafikut - vendkalim për këmbësorë dhe me pjesën e përparme të anës së majtë e godet këmbësoren dhe i shkaktonte lëndime trupore. Në të njëjtin raport, është konstatuar se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti - vetura e markës "V" tipi ..., e vitit ..., me targa të regjistrimit ..., ngjyrë ... - pronë e B.V, në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura, sipas policës nr...

Bazuar në faktin se pala e paditur në seancë përgaditore e ka kontestuar pjesërisht bazën juridike të kërkesëpadisë, sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës nga lëmia e komunikacionit, me ç'rast për ekspert është caktuar A.B, i përzgjedhur nga lista e ekspertëve gjyqësorë, me detyrë që mbi bazën e njohurive profesionale, t'i vlerësojë rrethanat dhe shkaqet që kanë sjellë deri tek aksidenti i komunikacionit i datës 26.02.2018, si dhe të sqarohet kontributi i pjesëmarrësve të përfshirë në këtë aksident.

Eksperti i lartëcekur ka përpiluar mendimin dhe konstatimin me shkrim me dt.26.03.2024, me ç'rast ka konstatuar se në bazë të materialit të prezantuar në shkresat e lëndës, daljes në vendin e ngjarjes dhe analizave të bërë janë nxjerrë këto konstatime: *"Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 26.02.2018, rreth orës 10:50 në rrugën "A.R"; Rruga ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit është rrugë lokale e shtruar me asfalt, me dy kahe të ndara me nga dy shirita, rruga kalon përgjatë zonës së urbanizuar dhe shpejtësia e lëvizjes është 40 km/h, e përshkruar në të dy anët e rrugës me trotuar për lëvizjen e këmbësorëve; Rruga është e rregulluar me sinjalizim horizontal dhe vertikal; Në vendin e ngjarjes nuk ka pasur gjurmë të frenimit dhe as skicë të përpiluar nga Policia e Kosovës; Moti në kohën e aksidentit ka qenë me borë, rruga e lagur, temperatura -3C deri -5C; Deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur kur drejtuesi i njësisë A, gjatë vozitjes nuk i ka kushtuar kujdes dhe nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në atë pjesë të rrugës".* Si vlerësim përfundimtar, eksperti ka dhënë këtë konstatim: *"Drejtuuesi i automjetit "A", z. B.V është shkaktar kryesor dhe i vetëm i aksidentit, ku i njëjti e ka drejtuar automjetin pa pasur kujdes të shtuar në atë pjesë të rrugës dhe duke mos respektuar shenjat*

e komunikacionit, vendkalimin për këmbësor, duke e goditur z. SH.K, e cila ka qenë duke kaluar rrugën në mënyrë të rregullt në vendkalim për këmbësorë; Këmbësorja z. SH.K, nuk është shkaktare e aksidentit të trafikut të datës 26.02.2018 dhe as nuk i ka kontribuar këtij aksidenti."

Eksperti i lartëcekur në kuptim të dispozitës nga neni 362 par.1 të LPK-së, ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.04.06.2024 për të dhënë sqarimet plotësuese. Palët ndërgjyqëse kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje ndaj kësaj ekspertize e as nuk kërkojnë sqarime shtesë nga eksperti i lartëcekur.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ka ngelur çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, lidhur me të cilën palët ndërgjyqëse kanë ngritur pikëpamje të ndryshme, me ç'rast pala e paditur pretendon se shumata e kërkuara nga ana e palës paditëse janë të larta.

Nga dokumentacioni mjekësor i bashkangjitur në shkresat e lëndës, respektivisht: Raporti i lëshuar nga QKUK, me numër 744, i dt.26.02.2018; Raportet e QKUK - Instituti i Biokimisë Klinike, të dt.27.02.2018; Raportet specialistike të dt.26.02.2018; 09.03.2018; Formulari për caktim të ekzaminimit i dt.29.03.2018; Udhëzimi për konsultim i dt.19.03.2018; Fletlëshimi i dt.20.03.2018, vërtetohet fakti se paditësja si pasojë e aksidentit i është nënshtruar tretmanit mjekësor të menjëhershëm dhe të nevojshëm pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me ç'rast fillimisht është dhënë diagnoza lidhur me natyrën e lëndimeve, ndërsa më tutje ky tretman është përcjellë me ndjekjen e terapive të rekomanduara lidhur me lëndimet e pësura nga mjekët përkatës të specializuar.

Sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore, dhe atë me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë, respektivisht e psikiatrisë, me ç'rast për ekspertë janë caktuar Dr. XH.S - Ortoped - traumatolog dhe Dr. V.B - Psikiatre. Ekspertët e lartëcekur kanë pasur për detyrë që në bazë të njohurive profesionale, pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të japin mendimin e tyre profesional lidhur me shkallën dhe intensitetin e lëndimeve të pësura, dhimbjeve fizike, frikës, si dhe të konstatojnë nëse te paditësja si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka ardhur në shprehje zvogëlimi i aktivitetit jetësor, shëmtimi dhe nëse ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë.

Ekspertët e lartëcekur kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim me dt.08.05.2024. Në mendimin e dhënë, ekspertët fillimisht kanë konstatuar se bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses kanë ardhë në këtë përfundim: "Paditësja SH.K në aksidentin e datës 26.02.2018 ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të qafës; Ndrydhje të krahrorit dhe belit; Ndrydhje të krahut të majtë dhe Thyerje të brinjës së V-të djathtas pa dislokim". Sipas ekspertëve përkatës, lëndimet e tilla kategorizohen si lëndime të rënda trupore, pa pasoja."

Në raport me dhimbjet fizike, ekspertët përkatës kanë konstatuar se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 20 minuta; të intensitetit të rëndë për 24

orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar; të intensitetit të mesëm 21 ditë, kohë e nevojshme për konsolidimin primar kockor të brinjë së thyer (në raport me moshën); të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen, ankon për dhimbje të kokës në anën e djathtë (sipas të dhënave nga paditësja referon se dy ditë pas aksidentit ka pasur gjakderdhje nga veshi i djathtë, më nuk dëgjon me të - nuk ka të dhëna të dokumentuara). Gjithashtu ankon për dhimbje të unazave të shpinës dhe belit, marramendje, humbje të ekuilibrit gjatë ngritjes nga krevati natën, si dhe dhimbje të vazhdueshme të kraharorit e cila herë pas here intensifikohet.

Në raport me frikën e përjetuar, është konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e shfaqur në momentin e aksidentit, pasi e njejta ka perceptuar rrezikun e drejtpërdrejtë për jetën dhe është frikësuar për përfundim fatal - vdekje; frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, si gjendje stresi pas traumës, e shfaqur me reagime emocionale, bazuar në mënyrën se si ka ndodhur aksidenti si dhe moshën e saj. Pas dhënies së ndihmës mjekësore dhe realizimit të ekzaminimeve të nevojshme diagnostifikuese, kjo frikë gradualisht është zbehur dhe ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur edhe për 6 javë, duke i përballur me pasojat shëndetësore të shkaktuara nga ky aksident, me konsultat dhe tretmanet e shumta mjekësore, mbajtjen e pozitës së detyruar për shkak të dhembjeve në regjionet trupore të atakuara në aksident, vështirësi për të realizuar aktivitetet e përditshme jetësore si më parë, brengosje dhe preokupim se mos ky aksident do t'i lë pasojat shëndetësore në të ardhmen. Për shkak të rikujtimit të ngjarjes traumatike, gjumit jo të rehatshëm, marramendjes dhe kokëdhembjes e ka kërkuar ndihmën e mjekut neuropsikiatër, i cili i ka përshkruar terapi adekuate; frikë sekondare të intensitetit të ulët - sipas të dhënave anamnestike dhe gjetjeve gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë psikiatrik, paditësja përjeton ende, herë pas here të manifestuar me frikë, ankth dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe në situata të ngjashme me atë të aksidentit të përjetuar. Shprehet që nuk guxon vetëm ta kalojë asnjëherë rrugën, qoftë edhe në vendin e caktuar për këmbësorë.

Shëmtim trupor si dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor është konstatuar se nuk ka.

Tutje në mendimin dhe konstatimin e dhënë, ekspertët përkatës kanë konstatuar se ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 21 ditësh, ndihmë e cila konsiston në përgaditjen e ushqimit dhe ndihmesave tjera ditore; ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh, i pasur me proteina, minerale, vitamina për përmirësim më të shpejtë të gjendjes së përgjithshme shëndetësore pas lëndimeve të pësuar; rehabilitimi fiziko - terapeutik ka qenë i nevojshëm për 20 ditë, të ndara në dy seanca nga 10 ditë, në raport me moshën.

Ekspertët e lartëcekur po ashtu në kuptim të dispozitës nga neni 362 par.1 të LPK-së kanë prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor për të dhënë sqarimet plotësuese. Ekspertja psikiatre Dr. V.B, në pyetjet e parashtruara nga i autorizuari i të paditurës ka sqaruar se mendimi dhe konstatimi në raport me frikën dhe intensitetin e frikës është bazuar në ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditëses si dhe dokumentacionin mjekësor të paraqitur në shkresat e lëndës,

duke shtuar tutje se në këtë vlerësim është marrë parasysh edhe mosha dhe gjendja e mëhershme shëndetësore e paditëses. Eksperti ortoped, Dr. XH.S, në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës lidhur me faktin se në çka konsistojnë lëndimet e rënda për paditësen, siç është konstatuar në ekspertizë, është përgjigjur se paditësja ka pasur thyerje të brinjë së 5-të djathtas dhe përderisa është prishur kontinuiteti i kësaj brinje, lëndimet e tilla janë vlerësuar si të rënda, pa pasoja.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, gjegjësisht përgjigjes në raport me pretendimet e parashtruara nga palët ndërgjyqëse, referuar natyrës dhe momentit kur është krijuar raporti juridik, duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj kahyrë në fuqi 6 muaj pas datës së publikimit. Dispozita nga neni 136, e cila i referohet bazave të përgjegjësisë për kompensimin e dëmit përcakton që: "*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*". Neni 137 i këtij ligji përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: "*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*". Në këtë mënyrë, nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur rezulton se ekzistojnë dy kategori të dëmit: 1) dëmi material, i cili ndahet në dy nënkategori: 1) zvogëlim i pasurisë dhe 2) pengim i rritjes së saj dhe 2) dëmi jo material, i cili konsiston në shkaktim të dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës. Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definon dispozita e nenit 169 të këtij ligji, e cila parasheh që: "*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata dotë caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme*". Në funksion të njejtë, dispozita e nenit 174 përcakton që: "*Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim*". Në anën tjetër, çështja e shpërblimit të dëmit jo material përcaktohetme dispozitën e nenit 183 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet epësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit*

material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se mete mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën saj dhe me qëllimin shoqëror."

- Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës -

Në rastin konkret, në bazë të të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartëcekura, rezulton se paditësja SH.K, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt.26.02.2018, ka pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike dhe frikë), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar dhe rehabilitim fiziko-klimaterik). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intentsitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore të dt.08.05.2024, të punuar nga ekspertët Dr. XH.S - Ortoped - traumatolog dhe Dr. V.B - Psikiatre. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizës në fjalë ia fali besimin e plotë, për faktin se është përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje. Krahas vërtetimit të faktit se paditësja ka pësuar format e lartëcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njejtit. Një detyrim i tillë buron nga fakti se shkaktari i aksidentit të komunikacionit, B.V, në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura, sipas policës nr... Faktet e tilla Gjykata i ka vërtetuar fillimisht në bazë të raportit të aksidentit Nr.2018-AR-0471, të përpiluar me datë 26.02.2018, e në veçanti nga ekspertiza nga lëmia e komunikacionit, e përpiluar me datë 26.03.2024 nga eksperti A.B. Të gjeturat e kësaj ekspertize, po ashtu janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizës në fjalë ia fali besimin e plotë, për faktin se është përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje.

Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësen tani është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të të paditurës për pagesën e një shume adekuate të të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajë paditëses shumë prej 2,500 Euro, duke marrë në referencë intentsitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore, ku theksohet se paditësja si pasojë e aksidentit ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 20 minuta; dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për 24 orë; dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 21 ditë, si dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët për të cilat paditësja ende ankohet kohë pas kohe.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë

paditëses shumë prej 2,200 Euro, po ashtu duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti i pësuar, të specifikuar në ekspertizën mjekësore, ku është konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda; frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur edhe për 6 javë pas aksidentit si dhe frikë sekondarë të intensitetit të ulët, të cilët paditësja e përjeton ende.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A – Su.A 41/2023, të dt.27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kritere orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ushqimit të përforcuar, t'ia paguajë paditëses shumë prej 300,00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësja si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sa i përket ndihmës së personit të tretë, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditëses shumë prej 250.00 Euro, duke marrë për bazë faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën kohore prej 21 ditësh.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihma e personit të tretë), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkaktimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirësuar për tu argumentuar lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit, në mbështetje të dispozitës nga neni 323 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësiqë të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.”*

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I të dispozitivit e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke gjykuar shumat e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin jo - material, shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditëses, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Në raport me dëmin material të pësuar, Gjykata vlerëson se shumat e përcaktuara janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të paditëses në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi.

- Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë -

Gjykata në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të dëmit jo - material, dhe atë: për dhimbjet fizike në shumën prej 5,500 €; si dhe për frikën e përjetuar në shumën prej 4,000 €. Po ashtu, u refuzua si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses në emër të kompensimit të dëmit material përtej shumave të gjykuara dhe atë: në emër të ushqimit të përforcuar në shumë prej 700.00 €, si dhe ndihmës së personit të tretë në shumë prej 800.00 €. Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditëses në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkakut të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirën e cenuar.

Në raport me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo - material në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e refuzoi në tërësi këtë pjesë të kërkesëpadisë në shumën prej 9,000 €, për faktin se nga ekspertiza mjekësore e përpiluar nga Dr. XH.S - Ortoped dhe Dr. V.B - Psikiatre, është konstatuar se tek paditësja nuk ka ardhur në shprehje zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor me rastin e aksidentit të pësuar.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve lidhur me rehabilitimin fiziko - psikiatrik dhe shpenzimet e shërimit, Gjykata mori në konsideratë faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se rehabilitimi klimaterik si pasojë e aksidentit për paditësen ka qenë i nevojshëm për 20 ditë, të ndara në dy seance nga 10 ditë. Megjithatë, pala paditëse nuk ka prezantuar ndonjë provë materiale në drejtim të argumentimit të lartësisë së këtyre shpenzimeve, ndërsa vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se shpenzimet e tilla, ndryshe nga ato që kanë të bëjnë me nevojën për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, lehtësisht mund të argumentohen përmes prezantimit të provave konkrete materiale (fatura, kuponë fiskalë etj). Mbi këtë bazë, u refuzua në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të rehabilitimit klimaterik t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,700 €, si dhe në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 1,200 €

- Vendimi lidhur me kamatën -

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditëses së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.12.06.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.03.04.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla*

debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata vendosi lidhur me shpenzimet e procedurës, në atë mënyrë që e detyroi të paditurën Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë paditëses SH.K shumën prej 177.66 €, Lidhur me këtë mënyrë të vendosjes, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 452 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që: "*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve". Në rastin konkret, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka paraqitur kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e përgjithshme prej 940.00 €. Gjykata mori në konsideratë faktin se nga tërësia e vlerës së kontestit prej 28,250.00 €, pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë konsiston në shumën prej 5,350.00 €, që nënkupton se shkalla e përgjithshme e suksesit në këtë procedurë arrin në nivelin prej 18.9 %. Mbi këtë bazë, Gjykata erdhi në përfundim se paditëses nga e paditura duhet t'i kompensohen shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 177.66 € ($940.00 \times 18.9 \% = 177.66$), shumë kjo proporcionale me suksesin e arritur në procedurë.*

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.1058/18, datë 12.06.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.